

VENDIM
Nr.215, datë 12.3.2020

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.47, DATË 22.1.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E NUMRIT TË
PUNONJËSVE ME KONTRATË TË PËRKOHSHME, PËR VITIN 2020, NË
NJËSITË E QEVERISJES QENDRORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 12, të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr.47, datë 22.1.2020, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Në pikën 1, numri i punonjësve me kontratë të përkohshme ndryshohet dhe bëhet 1 550.

2. Në lidhjen nr.1, të përmendur në pikën 1, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në ndarjen “Gr.05, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural”, ndarjen “Gr.06, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë”, ndarjen “Gr.13, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, ndarjen “Gr.16, Ministria e Brendshme” dhe ndarjen “Gr.17, Ministria e Mbrojtjes”, shtohen nënndarjet përkatëse, sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Në ndarjen “Gr.29, Këshilli i Lartë Gjyqësor”, numri i punonjësve të emërtesës “Sekretar gjyqësor” bëhet 5 dhe numri i punonjësve të emërtesës “Operator” bëhet 11. Numri total i punonjësve nuk ndryshon.

c) Në fund shtohen ndarjet “Gr.41, Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar” , “Gr.63, Inspektorati i Lartë i Drejtësisë” dhe “Gr.73, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve”, sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

II. garkohen ministritë dhe institucionet, sipas tabelës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, që të depozitojnë pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë detajimin e numrit të punonjësve me kontratë, periudhën kohore të punësimit dhe kategorinë përkatëse të pagës së tyre.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Tabela nr.1

Gr.	Emri i Institucionit		Emërtesa	Koha mesatare ditore	Periudhë kohore
5	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	8			
	AZHBR	2	Nëpunës Informacioni	6 orë/ditë	Mars-Dhjetor
	ISUV	4	Laborant	6 orë/ditë	Mars-Dhjetor
	ISUV	2	Teknik i Mesëm	6 orë/ditë	Mars-Dhjetor
6	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	3			
	Aparati i ministrisë	1	Teknik i Mesëm	6 orë/ditë	Mars-Dhjetor
	Aparati i ministrisë	2	Sanitar	6 orë/ditë	Mars-Dhjetor
13	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	20			
	Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore	10	Mjekë	8 orë/ditë	3 Muaj
	Qendra Kombëtare e Urgjencës Mjekësore	10	Infermierë	8 orë/ditë	3 Muaj
16	Ministria e Brendshme	2			
	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore	1	Sanitar	6 orë/ditë	Mars-Dhjetor
	Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore	1	Punonjës Arkive	6 orë/ditë	Mars-Dhjetor
17	Ministria e Mbrojtjes	25			
	Agjencia Kombëtare e Emergjencave Civile	25	Specialistë	8 orë/ditë	6 Muaj
41	Struktura e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar	8			
	Administrata e Strukturës	2	Specialist Arkive/Protokolli	8 orë/ditë	6 Muaj
	Administrata e Strukturës	2	Specialist Shërbimesh/burimesh nierëzore	8 orë/ditë	6 Muaj
	Administrata e Strukturës	2	Specialist regjistruar	8 orë/ditë	6 Muaj
	Administrata e Strukturës	2	Teknik i Mesëm	8 orë/ditë	6 Muaj
63	Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë	7			
	Administrata e ILD	1	Specialist Arkive/Protokolli	8 orë/ditë	6 Muaj
	Administrata e ILD	2	Specialist Shërbimesh/burimesh nierëzore	8 orë/ditë	6 Muaj
	Administrata e ILD	1	Specialist për marrdhënien me Publikun	8 orë/ditë	6 Muaj
	Administrata e ILD	3	Nëpunës Informacioni	6 orë/ditë	Mars-Dhjetor
73	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve	50			
	Administrata e KQZ	10	Specialist logjistike	8 orë/ditë	2 Muaj
	Administrata e KQZ	5	Operator	8 orë/ditë	2 Muaj
	Administrata e KQZ	35	Punonjës mirmbajtje	8 orë/ditë	2 Muaj
	TOTAL PUNONJËS ME KONTRATË	123			